



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **23 shkurt 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2023;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
7. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;
14. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

